

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare
të Raportimit Financiar më 31 dhjetor 2018

Përmbajtja

Pasqyrat financiare

Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	4

Shënime për pasqyrat financiare:

1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Baza e përgatitjes	5
3. Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara	5
4. Standardet e reja kontabël	7
5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	11
6. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël	16
7. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit	17
8. Menaxhimi i rrezikut financiar	20
9. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare	23
10. Mjete monetare dhe ekuivalente me to	24
11. Depozitat me afat me bankat	24
12. Investime në letra me vlerë	25
13. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve	25
14. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	26
15. Pajisje	26
16. Aktive të pa trupëzuara	26
17. Detyrime për kontratat e sigurimit	27
18. Rezerva për primet e pafituruar	28
19. Detyrimet të tjera	28
20. Kapitali aksionar	28
21. Prime të shkruara bruto	29
22. Shpenzimet e marrjes në sigurim	29
23. Shpenzime administrative	29
24. Transaksionet me palë të lidhura	30
25. Angazhimet dhe Kushtëzimet	30
26. Ngjarjet pas datës së raportimit	30

Skedulet plotësuese

Marzhi i aftësisë pagueuse	
Aktivitet në mbulim të rezervave teknike	

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionarit të Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.

Opinioni ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. ("shoqëria") më 31 dhjetor 2018, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Baza për opinionimin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* në raportin tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përbëhen nga skedulet suplementare të cilat përfshijnë aftësinë paguese dhe aktivet në mbulim të rezervave teknike.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk i përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk japim asnjë lloj sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe të konsiderojmë nëse ka ndonjë mospërputhje materiale të këtij informacioni me pasqyrat financiare ose informacionin e marrë prej nesh gjatë auditimit. Nëse bazuar në punën e kryer prej nesh në lidhje me informacionet e tjera të marra para datës së këtij raporti, ne arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në këto informacione të tjera, e raportojmë këtë si gjetje. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në lidhje me këtë çështje.



Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- arrijmë në përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së shoqërisë.



Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k.


PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k.
2 maj 2019
Prishtinë, Kosovë

Jonid Lamllari
Auditues Ligjor


SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyra e pozicionit financiar
(të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

	Shënimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
AKTIVET			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalentë	10	218,803	289,170
Depozita me afat me bankat	11	4,226,993	4,057,270
Investime në letra me vlerë	12	354,212	354,246
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve	13	437,081	205,943
Aktive të risigurimit		1,484	382
Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim	14	20,947	26,171
Pajisje	15	2,481	3,452
Pasurite e paprekshme	16	11,062	-
Parapagime		8,300	1,000
TOTALI I AKTIVEVE		5,281,363	4,937,634
DETYRIME			
Rezerva për kontratat e sigurimit	17	389,711	407,112
Rezerva për primin e pafitur nga kontratat e sigurimit	18	159,920	86,722
Detyrime të tjera	19	70,020	50,824
TOTALI I DETYRIMEVE		619,651	544,658
KAPITALI			
Kapitali aksionar	20	3,500,000	3,500,000
Fitime të pashpërndara		1,161,712	892,976
TOTALI I KAPITALIT		4,661,712	4,392,976
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		5,281,363	4,937,634

Këto pasqyra individuale financiare janë aprovuar nga menxhmenti i Shoqërisë më datën 30 prill 2019 dhe janë firmosur në emër të tyre nga:



Z. Perparim Drini
Drejtor i përgjithshëm



Znj. Vlera Halili
Drejtoresh e financave

Shënimet në faqet 5 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitime të pashpërndara	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2017	3,500,000	755,565	4,255,565
Fitimi i vitit	-	137,411	137,411
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	137,411	137,411
Gjendja më 31 dhjetor 2017	3,500,000	892,976	4,392,976
Fitimi i vitit	-	268,736	268,736
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	268,736	268,736
Gjendja më 31 dhjetor 2018	3,500,000	1,161,712	4,661,712

Shënimet në faqet 5 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Pasqyra e rrjedhës së parasë***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)*

		Për vitin e mbyllur Shënimi më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë operative			
Fitimi i vitit		268,736	137,411
<i>Rregullime për :</i>			
Zhvlerësimin	15,16	5,004	879
Shpenzimet e tatimit në të ardhurat e korporatave		42,825	31,833
Të ardhurat nga interesi		(51,832)	(50,679)
Të ardhurat nga investimet		(12,217)	(14,259)
		252,516	105,185
(Rritje)/rënie në rezervën e risiguruesit për primet e pafituara		(1,102)	1,005
Rritje në llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve		(230,583)	(77,422)
Rënie në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		5,224	4,864
(Rënie)/rritje në detyrimet për kontratat e sigurimit		(17,401)	105,336
Rritje në rezervat për primet e pafituara		73,198	31,297
Rritja/(rënie) në detyrimet e tjera		14,500	(15,279)
Rritje në parapagime		(7,300)	(1,000)
		89,052	153,986
Interesi i arkëtuar		43,805	65,706
Tatimi i paguar në të ardhurat e korporatave		(38,129)	(33,090)
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga veprimtaritë operative		94,728	186,602
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese			
Blerja e pajisjeve	15,16	(15,095)	(2,753)
Rritje në depozitat me afat me banka		(150,000)	(423,000)
Shlyerja e investime në letra me vlerë	11	-	300,000
Rrjedha e parasë e përdorur në veprimtaritë investuese		(165,095)	(125,753)
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to		(70,367)	60,849
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar		289,170	228,321
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor	10	218,803	289,170

Shënimet në faqet 5 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a. ("Shoqëria") në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a është një shoqëri aksionare e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Regjistrimit të Bizneseve më 10 maj 2011. Shoqëria është themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 dhe rregullit 31 të Bankës Qëndrore të Kosovës për licencimin e shoqërive të sigurimit të jetës në Kosovë të datës 18 dhjetor 2007. Shoqëria zotërohet nga Sigal Uniqa Group Austria Sh.a, një Shoqëri shqiptare, Shoqëria mëmë e së cilës është Uniqa Insurance Group AG Vienna, Austri ("UNIQA" ose "Pala kontrolluese përfundimtare"), një shoqëri aksionare e themeluar dhe e vendosur në Republikën e Austrisë. Shoqëria ofron shërbime të sigurimit të jetës si sigurimi personal, sigurimi i jetës me afat, sigurimi i jetës me kredi dhe sigurimi i jetës me kursim. Adresa e regjistruar e Shoqërisë dhe vendi i biznesit është "Pashko Vasa", nr.15, Prishtinë, Kosovë. Më 31 dhjetor 2018, Shoqëria kishte 11 punonjës (2017:11).

Drejtimi i Shoqërisë

Drejtimi i Shoqërisë gjatë vitit 2018 dhe deri në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, përbëhet nga:

Perparim Drini	Drejtor i Përgjithshëm
Dardan Nimani	Zv. Drejtor i Përgjithshëm
Vlera Halili	Drejtoresh e Financave

Bordi Mbikëqyrës gjatë vitit 2018 dhe deri në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, përbëhet nga:

Avni Ponari	Kryetar
Klement Mersini	Anëtar
Abdul Sarja	Anëtar
Elvis Ponari	Anëtar

2. Baza e përgatitjes

Deklarata e përputhshmërisë Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas konventës së kostos historike. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur thuhet ndryshe (shih Shënimet 3 dhe 4 për miratimin e standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara dhe deklaratave të reja kontabël të miratuara nga Shoqëria).

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kontabël. Ajo gjithashtu kërkon që Drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të shpalosura në Shënimin 6.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, që është monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon Shoqëria.

3. Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (të publikuara më 12 shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm, ose kur njësitë ekonomike së pari zbaton SNRF 9 për njësitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes). Ndryshimet adresojnë shqetësimet që dalin nga zbatimi i standardeve të reja financiare, SNRF 9, përpara zbatimit të standardit që BNSK po zhvillon për të zëvendësuar SNRF 4. Këto shqetësime përfshijnë paqëndrueshmërinë e përkohshme në rezultatet e raportuara. Ndryshimet paraqesin dy qasje: një qasje mbivendosje dhe një qasje e shtyrjes. Standardi i ndryshuar do t'i japë të gjitha shoqërive që lëshojnë kontrata sigurimi mundësinë për të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, në vend të fitimit ose humbjes, paqëndrueshmërinë që mund të lindë kur të zbatohet SNRF 9 përpara se të lëshohet kontrata e re e sigurimit. Përveç kësaj, standardi i ndryshuar do t'u japë ndërmarrjeve, aktivitetet e të cilave kryesisht lidhen me sigurimin e përjashtimit opsional të përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 deri në vitin 2021. Shoqëria pret të përdorë SNRF 9 duke filluar nga viti 2021 dhe nuk e ka zbatuar atë në asnjë fazë më të hershme.

3. Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 28 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Standardi i ri prezanton parimin kryesor që të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet i transferohen klientit, me çmimin e transaksionit. Çdo mall ose shërbim i lidhur që është i dallueshëm duhet të njihet veçmas, dhe çdo zbritje ose skonto me çmimin e kontratës në përgjithësi duhet të ndahet për elementët e veçantë. Kur shuma ndryshon për çfarëdo arsye, shuma minimale duhet të njihet nëse nuk ka një rrezik të madh për anulimin. Kostot e shkaktuara për të siguruar kontratat me klientët duhet të kapitalizohen dhe të amortizohen gjatë periudhës kur konsumohen përfitimet nga kontrata.

Ndryshimet në SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 12 prill 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Ndryshimet nuk ndryshojnë parimet themelore të Standardit, por sqarojnë se si duhet zbatuar këto parime. Ndryshimet sqarojnë se si të identifikojnë një detyrim (premtimi për të transferuar një të mirë ose një shërbim për një klient) në një kontratë; si të përcaktohet nëse një shoqëri është kryesori (ofruesi i një të mirë ose shërbimi) ose një agjent (përgjegjës për rregullimin e të mirave ose shërbimeve që duhet të ofrohen); dhe si të përcaktohet nëse të ardhurat nga dhënia e licencës duhet të njihen në një moment ose me kalimin e kohës. Përveç sqarimeve, ndryshimet përfshijnë dy lehtësime shitesë për të zvogëluar koston dhe kompleksitetin për një shoqëri kur ajo e zbaton në fillim standardin e ri. Shoqëria nuk ka pasur ndikim material pas zbatimit të standardit të ri. Klientët me kontrata të ndryshme nga kontratat e sigurimit janë të kufizuar dhe njohja e të ardhurave nuk ndryshon sipas standardit të ri.

KIRFN 22 - Transaksionet në valutë të huaj dhe konsiderata paraprake (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Interpretimi adreson mënyrën e përcaktimit të datës së transaksionit me qëllim të përcaktimit të kursit të këmbimit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivitetit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tij) lidhur me mosnjohjen e një aktivi jo-monetar ose detyrimi jo-monetar që rrjedh nga një paradhënie paraprake në një monedhë të huaj. Sipas SNK 21, data e transaksionit me qëllim të përcaktimit të kursit të këmbimit për tu përdorur në njohjen fillestare të aktivitetit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tyre) është data në të cilën një njësi ekonomike fillimisht njihë aktivin jo-monetar ose detyrim jo-monetar që rrjedh nga shuma paraprake. Nëse ka pagesa të shumta ose faturat parapagimi, atëherë njësi ekonomike duhet të përcaktojë datën e transaksionit për çdo pagesë ose marrje parapagimi. KIRFN 22 zbatohet vetëm në rrethanat në të cilat një njësi ekonomike njihë një aktiv jo-monetar ose detyrim jo-monetar që rrjedh nga një shqyrtim paraprak. KIRFN 22 nuk ofron udhëzime zbatimi për përcaktimin e zërave monetare dhe jo monetare. Një pagesë paradhënie ose marrje në përgjithësi shkakton njohjen e një aktivi jo-monetar ose të detyrimit jo-monetar, megjithatë, ai gjithashtu mund të krijojë një aktiv ose detyrim monetar.

Një njësi ekonomike mund të ketë nevojë të zbatojë gjykimin për të përcaktuar nëse një element është monetar ose jo-monetar. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Ndryshimet në SNRF 2, pagesa e bazuar në aksione (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Ndryshimet nënkuptojnë që kushtet e kushtëzimit të performancës jo të tregut do të ndikojnë në matjen e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione të rregulluara në mjete monetare në të njëjtën mënyrë si shpërblimet e shlyerjes së kapitalit. Ndryshimet sqarojnë gjithashtu klasifikimin e një transaksioni me një tipar të shlyerjes neto në të cilën njësi ekonomike mban një pjesë të specifikuar të instrumentave të kapitalit neto, të cilat përndryshe do t'u jepeshin palës tjetër pas ushtrimit (ose dhënies), në këmbim për shlyerjen e detyrimit tatimor të palës tjetër që shoqërohet me pagesën e bazuar në aksione. Marrëveshjet e tilla do të klasifikohen si kapital i rregulluar në tërësinë e tyre. Në përfundim, ndryshimet sqarojnë gjithashtu kontabilitetin për pagesat e bazuara në aksione të rregulluara në mjete monetare të cilat janë modifikuar për tu shlyer në kapital, si vijon (a) pagesa e bazuar në aksione matet duke iu referuar vlerës së drejtë të instrumentit të kapitalit të dhënë në datën e modifikimit; (b) detyrimi është çregjistruar pas modifikimit, (c) pagesa e bazuar në aksione të rregulluar me kapital, njihet deri në masën që shërbimet janë kryer deri në datën e modifikimit dhe (d) diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit në datën e modifikimit dhe shuma e njohur në kapital në të njëjtën datë, regjistrohet menjëherë në fitim ose humbje. Shoqëria nuk ka pagesa të bazuara në aksione prandaj këto ndryshime nuk kanë efekt në pasqyrat e saj financiare.

3. Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

Transferimet e pronës për investim - Ndryshimet në SNK 40 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Ndryshimet sqarojnë kërkesat për transferimet në ose nga prona për investim në lidhje me pronat në ndërtim e sipër. Para ndryshimeve, nuk kishte udhëzime specifike për transferimet e pronave për investim në ndërtim e sipër në SNK 40. Ndryshimi sqaron se nuk kishte ndërmend të ndalonte transfertat e një prone në ndërtim ose zhvillim, të klasifikuar më parë si inventar, tek prona për investim kur ka një ndryshim të dukshëm në përdorim. SNK 40 është ndryshuar për të përfshirë parimin e transfertave në ose jashtë pronës së investimit në SNK 40 për të specifikuar që një transferim në ose jashtë pronës së investimit duhet të bëhet vetëm kur ka pasur një ndryshim në përdorimin e pronës; dhe një ndryshim i tillë në përdorim do të përfshinte një vlerësim nëse prona kualifikohet si një pronë për investim. Një ndryshim i tillë në përdorim duhet të mbështetet me prova. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). SNRF 1 u ndryshua dhe disa nga përjashtimet afatshkurtra nga SNRF-të në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese rreth instrumenteve financiare, përfitimeve të punonjësve dhe njësive të investimit u hoqën, pasi ato përjashtime afatshkurtra e kanë shërbyer qëllimin e synuar. Ndryshimet në SNK 28 sqarojnë se një njësi ekonomike ka një zgjedhje në bazë investimi për matjen e investitorëve me vlerë të drejtë në përputhje me SNK 28 nga një organizatë e kapitaleve sipërmarrëse, ose një fond të përbashkët, njësi besimi ose njësi të ngjashme përfshirë fondet e sigurimeve të lidhura me investimet. Përveç kësaj, një njësi ekonomike që nuk është një njësi ekonomike investuese mund të ketë një shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët që është një njësi investimi. SNK 28 lejon një njësi ekonomike të tillë që të mbajë matjet e vlerës së drejtë të përdorura nga ai njësi ekonomike investuese ose sipërmarrje e përbashkët kur zbaton metodën e kapitalit neto. Ndryshimet sqarojnë se kjo zgjedhje është gjithashtu e disponueshme në bazë investimi. Pasqyrat financiare të Shoqërisë nuk u ndikuan nga keto ndryshime dhe përmirësime.

4. Standardet e reja kontabël

Janë nxjerrë disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019 ose më vonë dhe të cilat shoqëria nuk i ka miratuar në mënyrë të hershme.

SNRF 9 "Instrumentet financiare" (i ndryshuar në korrik 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Karakteristikat kryesore të standardit të ri janë:

- Aktivet financiare kërkohen të klasifikohen në tre kategori matëse: ato që duhet të maten më pas me koston e amortizuar, ato që maten më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI) dhe ato që maten më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVPL).
- Investimet në instrumentet e kapitalit maten gjithmonë me vlerën e drejtë. Megjithatë, drejtimi mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që instrumenti të mos mbahet për tregtim. Nëse instrumenti i kapitalit është mbajtur për tregtim, ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten në fitim ose humbje.
- Klasifikimi për instrumentet e borxhit udhëhiqet nga modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare dhe nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (SPPI). Nëse një instrument borxhi mbahet për tu mbledhur, ai mund të mbartet me koston e amortizuar nëse plotëson edhe kërkesat e SPPI. Instrumentet e borxhit që plotësojnë kërkesat e SPPI që mbahen në një portofol ku një njësi ekonomike zotëron të mbledhë flukse monetare të aktiveve dhe shet active, mund të klasifikohet si FVOCI. Aktivet financiare që nuk përmbajnë flukse monetare që janë SPPI duhet të maten në FVPL (për shembull, derivatet). Derivatet e përfshirë nuk janë më të ndarë nga aktivet financiare, por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të SPPI.
- Shumica e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare kanë mbetur të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që një njësi ekonomike do të kërkohet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e vet të kredisë për detyrimet financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në të ardhura të tjera përmbledhëse.

4. Standardet e reja kontabël (vazhdim)

- SNRF 9 paraqet një model të ri për njohjen e humbjeve nga zhvlerësimi - modeli i pritshëm i humbjeve të kreditit (ECL). Ekziston një qasje "me tre faza" e cila bazohet në ndryshimin në cilësinë e kredisë të aktiveve financiare që nga njohja fillestare. Në praktikë, rregullat e reja nënkuptojnë që njësitet ekonomike do të duhet të regjistrojnë një humbje të menjëhershme të barabartë me ECL 12 mujore për njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk janë të dëmtuara nga kredia (ose ECL gjatë jetës për të arkëtueshmet tregtare). Aty ku ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë, zhvlerësimi matet duke përdorur ECL-në e përgjeshme në vend të ECL-së 12-mujore. Modeli përfshin thjeshtimet operationale për qiranë dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare.
- Kërkesat mbrojtëse të kontabilitetit u ndryshuan për të harmonizuar kontabilitetin më ngushtë me menaxhimin e riskut. Standardi i ofron njësitet ekonomike një zgjedhje të politikës kontabël ndërmjet zbatimit të kërkesave mbrojtëse të kontabilitetit të SNRF 9 dhe vazhdimit të zbatimit të SNK 39 në të gjitha mbrojtjet sepse standardi aktualisht nuk trajton kontabilizimin për mbrojtje makro.

Shoqëria ka zgjedhur të zbatojë opsionin e përgjashimit të përkohshëm dhe pret ta zbatojë IFRS 9 duke filluar nga viti 2021.

SNRF 16 "Qiratë" (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë në faktin që qiramarrësi ka të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, gjithashtu merr financime. Prandaj, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave qoftë kjo si qera operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësit do të kërkohet të njohin: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi nënligjor është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të qirasë veç e veç nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 16 në thelb përcjell kërkesat e kontabilitetit të qiradhënësit në SNK 17. Prandaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera operative ose qira financiare dhe të llogarisë këto dy lloje të qirasë ndryshe. Shoqëria vendosi që do të zbatojë standardin e ri nga data e tij e detyrueshme e zbatimit 1 janar 2019 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitur shifrat krahasuese. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

SNRF 17 "Kontratat e sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021). SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili i ka dhënë mundësi shoqërive që të mbajnë kontabilitetin për kontratat e sigurimit duke përdorur praktikat ekzistuese. Si pasojë, ishte e vështirë për investitorët të krahasojnë performancën financiare të shoqërive të ngjashme të sigurimit. SNRF 17 është një standard i vetëm i bazuar në parime për të llogaritur të gjitha llojet e kontratave të sigurimit, duke përfshirë kontratat e risigurimit që një siguruues mban. Standardi kërkon njohjen dhe matjen e grupeve të kontratave të sigurimit në: (i) një vlerë aktuale të rregulluar nga risku i flukseve të ardhshme të parasë (flukset monetare të përmbushjes) që përfshijnë të gjithë informacionin në dispozicion për flukset e mjeteve monetare të përmbushjes në një mënyrë që është në përputhje me informacionin e tregut të vëzhgueshëm; plus (nëse kjo vlerë është një detyrim) ose minus (nëse kjo vlerë është një aktiv) (ii) një shumë që përfaqëson fitimin e pafitur në grupin e kontratave (marzhi i shërbimit kontraktual). Siguruessit do të njohin fitimin nga një grup i kontratave të sigurimit gjatë periudhës që ata ofrojnë mbulim sigurimi, dhe pasi ato lirohen nga rreziku. Nëse një grup i kontratave është ose bëhet humbje, një njësi ekonomike do të njohë menjëherë humbjen. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

KIRFN 23 "Pasiguria mbi trajtimin e taksave mbi të ardhurat" (publikuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). SNK 12 specifikon mënyrën e llogaritjes së tatimit aktual dhe të shtyrë, por jo si të pasqyrojë efektet e pasigurisë. Interpretimi sqaron se si të zbatohen kërkesat e njohjes dhe të matjes në SNK 12 kur ka pasiguri mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat. Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim të pasigurt tatimor veç e veç ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore bazuar në atë metodë që parashikon sa më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike duhet të supozojë se një autoritet tatimor do të shqyrtojë shumat që ka të drejtë të shqyrtojë dhe të ketë njohuri të plotë për të gjitha informacionet e lidhura me to gjatë kryerjes së këtyre kontrolleve.

4. Standardet e reja kontabël (vazhdim)

Nëse një njësi ekonomike arrin në përfundim se nuk është e mundur që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim të pasigurt tatimor, efekti i pasigurisë do të pasqyrohet në përcaktimin e fitimit ose humbjes së tatueshme, bazës tatimore, humbjeve tatimore të papërdorura, kredive të papërdorura tatimore ose normave tatimore duke përdorur shumën më të mundshme ose vlerën e pritur, në varësi të metodës që njësi ekonomike pret të parashikojë më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike do të pasqyrojë efektin e një ndryshimi në fakte dhe rrethana ose në informacione të reja që ndikojnë në gjykimet ose vlerësimet e kërkuara nga interpretimi si një ndryshim në vlerësimin kontabël. Shembujt e ndryshimeve në fakte dhe rrethana ose informacione të reja që mund të rezultojnë në rivlerësimin e një gjykimi apo vlerësimi përfshijnë, por nuk kufizohen në, ekzaminimet ose veprimet e një autoriteti tatimor, ndryshimet në rregullat e vendosura nga një autoritet tatimor ose skadimi i një e drejta e autoritetit tatimor për të shqyrtuar ose rishqyrtuar një trajtim tatimor. Mungesa e një marrëveshjeje ose mosmarrëveshjeje nga një autoritet tatimor me një trajtim tatimor, të veçuar, nuk ka të ngjarë të përbëjë një ndryshim në fakte dhe rrethana apo informata të reja që ndikojnë në gjykimet dhe vlerësimet e kërkuara nga interpretimi. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Shitja ose dhurimi i aktiveve midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK). Këto ndryshime adresojnë një mospërputhje midis kërkesave të SNRF 10 dhe atyre në SNK 28 në trajtimin e shitjes ose të kontributit të aktiveve ndërmjet një investitori dhe shoqërisë së tij ose sipërmarrjes së përbashkët. Pasoja kryesore e ndryshimeve është se një fitim ose humbje e plotë njihet kur një transaksion përfshin një biznes. Një fitim ose humbje e pjesëshme njihet kur një transaksion përfshin aktivet që nuk përbëjnë një biznes, edhe nëse këto mjete mbahen nga një filial. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshimet në SNRF 9 (publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Ndryshimet mundësojnë matjen me koston e amortizuar të kredive të caktuara dhe letrave me vlerë të borxhit që mund të parapagohen me një shumë nën koston e amortizuar, për shembull me vlerën e drejtë ose në një shumë që përfshin një kompensim të arsyeshëm të pagueshëm ndaj huamarrësit të barabartë me vlerën aktuale të një efekti rritja e normës së interesit të tregut gjatë jetës së mbetur të instrumentit. Përveç kësaj, teksti i shtuar në bazë të standardeve për përfundim rikonfirmon udhëzimet ekzistuese në SNRF 9 se modifikimet ose shkëmbimet e disa detyrimeve financiare të matura me koston e amortizuar që nuk rezultojnë në çregjistrim do të rezultojnë në një fitim ose humbje në fitim ose humbje. Subjektet raportuese kështu në shumicën e rasteve nuk do të jenë në gjendje të rishikojnë normën efektive të interesit për jetën e mbetur të huasë në mënyrë që të shmanget një ndikim në fitim ose humbje pas modifikimit të kredisë. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Interesat afatgjata në shoqëritë dhe sipërmarrjet e përbashkëta - Ndryshimet në SNK 28 (publikuar më 12 Tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019). Ndryshimet sqarojnë që njësitë raportuese duhet të zbatojnë SNRF 9 për huatë afatgjata, aksionet preferenciale dhe instrumente të ngjashme që janë pjesë e një investimi neto në një metodë të kapitalit neto të investuar para se të mund ta zvogëlojnë këtë vlerë bartëse me një pjesë të humbjes së të investuarit që tejkalon shumën e interesit të investitorit në aksionet e zakonshme. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Përmirësimet vjetore të SNRF-ve 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (publikuar më 12 Dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019).

Ndryshimet ndikojnë në katër standarde. Në SNRF 3 u sqarua se një blerës duhet të rimendojë interesin e tij të mbajtur më parë në një operacion të përbashkët kur të marrë kontrollin e biznesit. Në anën tjetër, SNRF 11 tani shpjegon në mënyrë eksplicite se investitori nuk duhet të rimarrë peshën e interesit të mbajtur më parë kur të marrë kontrollin e përbashkët të një operacioni të përbashkët, ngjashëm me kërkesat ekzistuese kur një pjesëmarrës bëhet një sipërmarrje e përbashkët dhe anasjelltas. SNK 12 i ndryshuar shpjegon se një njësi ekonomike njihet të gjitha pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në rastet kur ka njohur transaksionet ose ngjarjet që gjenerojnë fitimet e shpërndara, p.sh. në fitim ose humbje ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

4. Standardet e reja kontabël (vazhdim)

Tani është e qartë se kjo kërkesë zbatohet në të gjitha rrethanat përderisa pagesat për instrumentet financiare të klasifikuara si kapital janë shpërndarjet e fitimeve dhe jo vetëm në rastet kur pasojat tatimore janë rezultat i normave të ndryshme tatimore për fitimet e shpërndara dhe të pashpërndara. SNK 23 i rishikuar tani përfshin udhëzime të qarta se huamarrjet e fituara posaçërisht për financimin e një aktivi të specifikuar janë përjashtuar nga grupi i kostove të huasë të përgjithshme të pranueshme për kapitalizim vetëm derisa aktivi specifik është në thelb i plotë. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Ndryshimet në SNK 19 “Ndryshimet, shkurtimet ose shlyerja e planit” (publikuar më 7 Shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019). Ndryshimet qartësojnë përlllogartjen e shpenzimeve për pensionin në momentin kur ndodhin ndryshime në planin e pensionit me përfitime të përcaktuara. Kur një ndryshim ndodh: përmirësim, shkurtim ose shlyerje; SNK 19 kërkon që të ri-llogaritet përfitimi i përcaktuar neto si detyrim ose si aktiv. Përmirësimet në standart kërkojnë përdorimin e supozimeve të përditësuara nga kjo ri-llogaritje në mënyrë që të përcaktohet kosto aktuale e shërbimit dhe intersi neto për pjesën e mbetur të periudhës raportuese pas ndryshimit të planit. Para se të bëhej ky përmirësim në standart, SNK 19 nuk përcaktonte llogaritjen e këtyre shpenzimeve për periudhën pasi bëhej ndonjë ndryshim në plan. Duke e bërë një domosdoshmëri përdorimin e supozimeve të përditësuara, standarti i ndryshuar pritet që të japi një informacion të dobishëm përdoruesve të pasqyrave financiare. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Ndryshimet në kuadrin konceptual për raportim financiar (publikuar më 29 Mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020). Kuadri konceptual i rishikuar përfshin një kapitull të ri mbi llogaritjen; udhëzime për performacën e raportimit financiar; përkufizime dhe udhëzime të përmirësuara në veçanti përkufizimin e detyrimeve; dhe sqarimi në lidhje me fusha të rëndësishme si psh: roli i menaxhimit, matja dhe reduktimi i pasigurisë në raportimin financiar.

Përkufizimi i një biznesi – Ndryshimet në SNRF 3 (publikuar më 22 Tetor dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020). Ndryshimet rishikojnë përkufizimin e një biznesi. Biznesi duhet të ketë inpute dhe procese të vazhdueshme, ku së bashku të kontribuojnë në mënyrë që të krijohet output. Udhëzimi i ri ofron një kornizë për të vlerësuar kur një input dhe një proces substancial janë të pranishëm, duke përfshirë edhe shoqëritë në fazat e hershme që nuk kanë gjeneruar ende outpute. Një forcë punëtore e organizuar duhet të jetë e pranishme si kusht për klasifikimin si biznes nëqoftëse nuk ka ende outpute. Përkufizimi i termit “output” është ngushtuar dhe fokusuar në shërbimet dhe mallrat që i ofrohen konsumatorëve, duke gjeneruar të ardhura nga investimet dhe të ardhura të tjera dhe përjashton të ardhurat në që vijnë nga reduktimi i kostove dhe të ardhurat nga përfitimet e tjera ekonomike. Gjithashtu nuk është më e nevojshme të vlerësohet nëse pjesëmarrësit e tregut janë në gjendje të zëvendësojnë elementët e humbur ose të integrojnë aktivitetet dhe aktivet e fituara. Një njësi ekonomike mund të zbatojë një 'test përqëndrimi'. Aktivitetet e blera nuk do të mund të përfaqësojnë një biznes nëqoftëse e gjithë vlera e drejtë e aktiveve bruto të blera është e përqëndruar në një aktiv të vetëm (ose në disa aktive të ngjashme). Ndryshimet janë të mundshme dhe shoqëria do t'i zbatojë ato dhe do të vlerësojë ndikimin e tyre duke filluar nga data 1 Janar 2020.

Përkufizimi i materialitetit – Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 Tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020). Ndryshimet sqarojnë përkufizimin e materialit dhe si duhet zbatuar duke përfshirë në udhëzimin e përcaktimit që deri më tani ka paraqitur diku tjetër në SNRF. Përveç kësaj, shpjegimet që shoqërojnë përkufizimin janë përmirësuar. Së fundmi, ndryshimet sigurojnë që përkufizimi i materialit të jetë i qëndrueshëm në të gjitha standardet e SNRF-ve. Informacioni është material nëse mospërfshirja, anashkalimi ose fshehja e tij pritet që të influencojë vendimet e marra duke u bazuar në këto pasqyra financiare nga përdoruesit kryesorë. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare. Përveç nëse është përshkruar ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare nga Shoqëria, përveç nëse është shprehur ndryshe.

(a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale në kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare që maten me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me normen e këmbimit në datën në të cilën përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj përkthehen në kursin e këmbimit të çastit në datën e transaksionit. Diferenca në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi përgjithësisht njihen në fitim ose humbje.

(b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Kontrata nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të ardhshme të mundshme në një ose më shumë norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese, indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiarë kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

(c) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

(i) Primet e sigurimit jetësor

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumën e detyruar gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma i përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatimet mbi prime. Pjesa e fituar e primeve të arkëtuar njihet si e ardhur. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar. Primet e risigurimit njihen si shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të marrë të risigurimit.

(ii) Rezerva e primit te pafituar

Rezerva për primin e pafituar të jetës me afat dhe sigurimit personal është llogaritur nëpërmjet metodave aktuariale duke marrë në konsideratë vlerën e pamaturuar të policës së sigurimit të rregulluar me koeficientin e rrezikut të vdekshmërisë, për rrezikun e humbjes së jetës. Shoqëria ka përdorur metodën pro-rata (metodën 1/365) për të përcaktuar primin e pafituar. Primi i pafituar për sigurimin e mbrojtjes së pagesave ("PPI") është llogaritur bruto nga shpenzimet e marrjes në sigurim. Efekti i kostos së marrjes në sigurim është vlerësuar bazuar në normën e shpenzimeve të marrjes në sigurim ndaj primit të shkruar bruto.

(iii) Dëmet

Përfitimet e ndodhura për sigurimin e jetës gjatë aktivitetit të përgjithshëm përbëhen nga dëmet e paguara gjatë vitit financiar bashkë me ndryshimin në rezervën për dëmet pezull. Rikuperimet në avancë nga risigurimi paraqiten më vete si aktive. Rikuperimet nga risigurimi dhe rikuperime të tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull.

(iv) Rezerva për dëmet

Rezerva përfaqëson vlerësimin e kostos përfundimtare të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes së dëmit, të cilat lindin nga ngjarje që kanë ndodhur deri në datën e raportimit, duke përfshirë një llogaritje të kostos së dëmeve të ndodhura por të pa raportuara (IBNR) në atë datë. Rezerva për dëmet pezull krijohet rast pas rasti në bazë të shumës së pritshme. Rezervat për dëmet e ndodhura por të pa raportuara krijohen përmes metodës të thjeshtëzuar të koeficientit të dëmeve.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (vazhdim)

(v) Deme që lindin nga veprimtaria e sigurimit të jetës

Demet e biznesit për sigurimin e jetës pasqyrojnë koston e të gjitha dëmeve që dalin gjatë vitit, duke përfshirë shpërblimet e policave të akorduara në pritje të një deklarate bonusi

(vi) Rezerva të tjera matematikore

Rezerva për sigurimin e jetës llogaritet mbi një bazë të policave të sigurimit, duke përdorur formulën standarde aktuarile të faktorit të komutimit, bazuar në rezervën neto. Supozimet mbi vdekshmërinë dhe normën e interesit të përdorur në percaktimin e rezerves, janë në përputhje me supozimet e çmimeve.

(vii) Risigurimi

Kontratat që transferojnë një pjesë kryesore të rrezikut të sigurimit janë kontabilizuar si risigurime. Shumat e rikuperueshme nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit si dhe demet e lidhura. Aktivitetet e risigurimit përfshijnë balancat për t'u arkëtuar nga Shoqëritë e risigurimit për detyrimet nga sigurimet e ceduara. Shumat e rikuperueshme nga risiguresit llogariten në të njëjtën mënyrë si janë llogaritur rezervat e dëmeve pezull, ose përbëjnë pjesën e papaguar nga risiguresi të dëmeve të paguara nga Shoqëria që lidhen me policën e risiguar. Shoqëria cedon primet e sigurimit dhe rrezikun për të limituar humbjet e mundshme lindur nga ekspozimi në rreziqe të konsiderueshme nga sigurimi i jetës. Risigurimi nuk e liron siguresin fillestar nga detyrimet e tij. Primet e ceduara paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën e ngarkuar gjatë vitit. Shumat e rimbursuara janë paraqitur në pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe në pasqyrën e pozicionit financiar në bazë bruto. Portofoli i produkteve është mbuluar nga një kontratë risigurimi e detyrueshme që mbulon pjesën mbi shumën maksimale të rrezikut lidhur me policat e sigurimit. Çdo përfitim shtesë, ndahet midis shumës së mbajtur dhe tejkallimit në të njëjtin proporcion si shuma e siguruar e jetës. Pjesa e rezervës së risigurimit përcaktohet rast pas rasti në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

(viii) Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të policave të sigurimit të jetës me kursim, afateve të rregullta dhe afateve të veçanta. Për policat Jeta me Afat, shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të komisionit të përcaktuar në baza individuale të policave. Komisioni i paguar për çdo policë është i ndarë nga shuma e shkruar e asaj police. Raporti që rezulton është shumëfishuar me rezervat e primet të pafitur të primeve bruto të shkruara. Si rezultat, shpenzimet e marrjes shtyhen për kohëzgjatjen e policave përkatëse. Për policat e sigurimit me kursim, shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë llogaritur në përputhje me Standardet e kostove të shtyra të marrjes në sigurim të Uniqa Group. Shoqëria ka zbatuar qasjen e thjeshtuar të specifikuar në standard. Kështu që për llogaritje është përdorur skedari i thjeshtuar i standardeve i ofruar nga Grupi, së bashku me supozimet e mëposhtme:

- Normat e zbritjes - Normat e liruara nga rreziku që llogariten dhe merren nga Grupi
- Normat e ndalimit - normat e llogaritura në bazë të përvojës së portofolit
- Shkalla e vdekshmërisë - vdekshmëria nga TM-ja e përshtatur për mbajtësin e policës mesatare për secilin vit të nënshkrimit
- Komisioni - komisionet aktuale të brokerimit.

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si shpenzime që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit, si dhe shpenzimet administrative të ndara lidhur me përpunimin e propozimeve dhe lëshimin e policave.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Instrumentet financiare

Shoqëria klasifikon aktivet financiare jo-derivative në hua dhe të arkëtueshme dhe në aktivet e tjera financiare që mbahen në maturim dhe në detyrime financiare jo-derivative.

(i) Aktivet dhe detyrimet financiare jo derivative – Njohja dhe çregjistrimi

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme në datën kur ato janë krijuar.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale rrjedhës së parave nga aktivi financiar, ose ajo transferon të drejtat për të marrë rrjedha kontraktuale të parave në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar ose në të cilat Shoqëria as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivit financiar. Çdo interes në aktivet financiare të tilla të çregjistruara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

(ii) Aktivet dhe detyrimet financiare jo derivative – Matja

Huamarrjet dhe llogaritë e arkëtueshme dhe aktivet financiare të mbajtura deri në maturim fillimisht maten me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që i atribuohet drejtpërdrejtë. Pas njohjes fillestare, ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Detyrimet e tjera financiare jo-derivative fillimisht maten me vlerën e drejtë minus koston e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejtë. Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(iii) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtoje ose të mbyll aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga standardet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

(iv) Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbëhet ose një detyrim mund të paguhet midis palëve që kanë njohurinë dhe mundësinë të kryejnë transaksione në marrëdhënie normale tregu në datën e matjes. Kur është e mundshme, Shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar për këtë instrument në tregje aktive. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknikat e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimet e një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit perkatesisht vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Shoqëria konstaton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimin e transaksionit. Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni mbyllet.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Instrumentet financiare (vazhdim)

(v) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse ka dëshmi objektive që aktivet financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë të zhvlerësuara. Aktivet financiare janë të zhvlerësuara kur dëshmitë objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të aktivitetit që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar mund të përfshijë mos-pagesen ose delinkuencën e huamarresit, ristrukturimin e kredisë ose paradhënies nga Shoqëria me kushte që, në rrethana të tjera, nuk do të kishte konsideruar, tregues se një huamarrës ose emëtues do të futet në probleme likuiditeti, ose të dhëna të tjera të monitorueshme lidhur me një grup aktivesh sikurse lëvizjet e pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësit për Shoqërinë, ose kushte ekonomike që janë në korrelacion me mos-pagesen në grup.

Shoqëria merr parasysh dëshmi të zhvlerësimit në nivele kolektive dhe specifike. Kreditë në nivel kolektiv vlerësohen për zhvlerësim duke grupuar së bashku huamarrësit me karakteristika të ngjashme të kredisë. Kreditë në nivel specifik identifikohen në bazë të dëshmimeve objektive të një niveli rreziku që tejkalon nivelin historik të rrezikut të kredive të tilla si mungesa, ristrukturimi, kushtet e përkeqësuar ekonomike dhe delikuencës së më shumë se 90 ditëve për një huamarrës të vetëm që nuk ka të ardhura të evidentuara. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi kthehet në fitim ose humbje.

(f) Mjetet monetare dhe të tjera ekuivalentë

Mjetet monetare dhe të tjera ekuivalentë përbëhet nga bilancet në para të gatshme, paratë e depozituara në bankat komerciale dhe investimet afatshkurtëra me likuiditet të lartë me afat maturimi prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që i nënshtrohen një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe janë përdorur nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(g) Depozitat me afat

Depozitat me afat janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit të mbetur dhe klasifikohen si ato me maturim fillestar më shumë se tre muaj. Interesi është përlllogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe interesat e arkëtueshme pasqyrohen në të arkëtueshmet e tjera.

(h) Investimi në letra me vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuar, minus provizionin për rënien në vlerë. Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje.

(i) Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë llogaritë e arkëtueshme nga të siguruarit dhe njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar minus humbjet nga rënia në vlerë.

(j) Llogaritë e pagueshme nga sigurimet dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme nga sigurimi dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksioneve të lidhura drejtpërdrejtë me të. Këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Pajisje

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pajisjeve maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejtë të atribuueshme për blerjen e pajisjes. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitetit në punë si edhe kostot çmontimit e rikthimit të vendit në të cilin ato do të vendosen, në gjendjen e tij fillestare. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kapitalizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë ndarë (përbërës kryesorë) të pajisjeve.

(ii) Kostot e mëvonshme

Kostoja e zëvendësimit të një elementi të pajisjeve i shtohet vlerës kontabël të këtij elementi nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhen me këtë element do të shkojnë për Shoqërinë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e mirëmbajtjes ditore të pajisjeve njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në momentin kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi dhe amortizimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes duke përdorur metodën e llogaritjes mbi vlerën e mbetur. Aktivitetet e marra me qira zhvlerësohen për perudhën më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk zhvlerësohet. Normat e zhvlerësimit për periudhat aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	4 vite
Mobilje, instalime dhe pajisje	5 vite

Aktivitetet e patrupezuara kanë jetëgjatësi të përcaktuara prej 4 vitesh dhe amortizohen përgjatë kësaj periudhe.

(l) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatiomore të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, vlera e rikuperueshme vlerësohet. Një humbje nga rënia në vlerë njihet kurdoherë që vlera që mban një aktiv ose njësi e tij e gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Njësi gjeneruese e mjeteve monetare është njësi më e vogël e identifikueshme e grupimit të aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot e shitjes. Në përlllogaritjen e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme aktualizohen duke përdorur një normë të rregulluar për efektin e taksës e cila reflekton vlerësimet e tregut për vlerën në kohë të pasasë si edhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbja nga rënia e vlerës të njohura nga periudha e mëparshme financiare, rishikohet në çdo vit për të vlerësuar nëse ka tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga rënia në vlerë rimerret nëse ka patur ndonjë ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë kthehet vetëm në masën, me të cilën vlera që aktivi mban, nuk tejkalon vlerën e mbetur të tij e cila do ishte përcaktuar si vlera neto pas zhvlerësimit nëse nuk do ishte njohur humbja nga rënia në vlerë.

(m) Njohja e të ardhurave

Politikat kontabël për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në notën 5.c.i. Të ardhurat nga interesi për aktivet financiare janë njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(n) Përfitimit e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni kur këta të fundit dalin në pension. Qeveria është përgjegjëse për sigurimin e kufirit minimal ligjor për pensionet në Kosovë sipas një plani pensional me kontribute të përcaktuara. Kontributet e Shoqërisë në planin e pensionit ngarkohen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes kur ato ndodhin dhe Shoqëria nuk detyrime të tjera.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(o) Qiratë operacionale

Qiratë në të cilat një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë lineare për të gjithë periudhën e qirasë. Kur një qira operative përfundon para afatit të qirasë paracaktuar, çdo pagesë që kërkohet t'i bëhet qiradhënësit me anë të ndëshkimit, njihet si një shpenzim në periudhën në të cilën ndërprerja ndodh.

(p) Provizionet

Një provizion njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të parave të gatshme në normën para tatimit. Provizionet pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për detyrimin.

(q) Tatimi në të ardhura të korporatave

Duke filluar nga data 1 shtator 2015, në përputhje me Ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave të Republikës së Kosovës nr. 05 / L-029, Shoqëritë e sigurimeve duhet të paguajnë një taksë prej 5% (2017: 5%) ne primet bruto të shkruara, cdo tremuaj.

Tatimi mbi primet bruto të shkruara është paraqitur veçmas si një zbritje nga primet e shkruara bruto. Tatimi mbi primet përbën një pjesë të shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe njihet si shpenzim në momentin që ndodh. Për shkak të specifikave, tatimi i shtyre nuk llogaritet për arsye se nuk ka diferenca të perkohshme midis bazes tatimore dhe kontabel të aktiveve dhe detyrimeve.

6. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura bazohen në përvojën historike dhe faktorët e ndryshëm që besohet të jenë të arsyeshëm në rrethanat dhe informacionet e disponueshme në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime mbi vlerat që mbajnë aktivet dhe detyrimet që nuk janë të dukshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse ndryshimi ndikon në periudhat aktuale dhe në të ardhmen.

Gjykimet e bëra nga drejtimi në zbatimin e SNRF-ve që kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe vlerësimet me një rrezik të konsiderueshëm të përshtatjes materiale në vitin e ardhshëm janë shpalosur më poshtë.

Vlerësimi përfundimtar që lind nga dëmet sipas kontratave të sigurimit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që rrjedh nga dëmet sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi kontabël më i rëndësishëm i Shoqërisë. Në këtë vlerësim duhet të përfshihen disa burime të rëndësishme të pasigurisë për vlerësimin e detyrimit përfundimtar të Shoqërisë për këto dëme.

Përcaktimi i detyrimeve sipas kontratave afatgjata të sigurimit varet nga vlerësimet e bëra nga Shoqëria. Vlerësimet bëhen duke marrë parasysh pritshmëritë për numrin e vdekjeve për çdo vit në të cilin Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut. Shoqëria i bën këto vlerësime bazuar tek tabelat e personalizuara të vdekshmërisë të rajonit për shkak të mungesave të të dhënave të besueshme në Kosovë të cilat përshtaten për të reflektuar përvojën e vetë Shoqërisë. Për kontratat të cilat sigurojnë rrezikun e jetëgjatësisë, krijohet një pritshmëri e kujdesshme por jo e tepruar për përmirësimet në lidhje me vdekshmërinë. Burimi kryesor i pasigurisë është që epidemitë (psh. SIDA, SARS dhe ndryshime të rëndësishme të stilit të jetesës, të tilla si ushqimi, pirja e duhanit, programet e ushtrimit, traumat e pasluftës mund të rezultojnë në pritshmëritë e vdekshmërisë të qenit në mënyrë të rëndësishme më keq se në të shkuarën për grup moshë ndaj të cilave Shoqëria është e ekspozuar në mënyrë të rëndësishme ndaj rrezikut të vdekjes).

6. Vleresimet dhe gjykimet kontabël (vazhdim)

Megjithatë, përmirësimet e vazhdueshme në kujdesin mjekësor dhe kushtet sociale mund të rezultojnë në përmirësime të jetëgjatësisë përtej atyre të marra parasysh në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e detyrimeve që lindin nga kontratat kur Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të jetëgjatësisë.

Në çdo datë raportimi, Shoqëria kryen analiza për t'u siguruar mbi mjaftueshmërinë e rezervave për kontratat e sigurimit. Testet kryesore lidhen me analizat e raportit të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit mbi linjat kryesore të aktivitetit në mënyrë individuale (sigurimi i jetës për hua dhe sigurimi i kombinuar). Llogaritja kryhet vetëm mbi dëmet si dhe mbi dëmet duke përfshirë shpenzimet e marrjes në sigurim dhe shpenzime të tjera të trajtimit. Gjatë kryerjes së kësaj analize, Shoqëria merr parasysh vlerësimet aktuale të flukseve dalëse të parasë. Shoqëria nuk i skonton këto flukse dalëse sepse pjesa më e madhe e dëmeve pritet të paguhet brenda një viti. Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë për supozimet kryesore të përdorura për vlerësimin e detyrimeve nga dëmet paraqitet në shënimin 7.

7. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut aktuarial dhe marrjes në sigurim që rrjedhin nga një gamë e gjerë e produkteve të jetës të ofruara për konsumatorët.

Rreziku i sigurimit ka të bëjë me pasigurinë e biznesit të sigurimit. Komponentët më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Kjo ka të bëjë me shqetësimin në lidhje me përshtatshmërinë e nivelit të normës së primit të sigurimit dhe mjaftueshmërinë e rezervave për detyrimet e sigurimit dhe baza e kapitalit.

Rreziku i primit është i pranishëm sapo është lëshuar polica e sigurimit, dhe është rreziku që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku rezervës paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i nënvlerësuar ose që pretendimet faktike do të luhaten rreth vlerës statistikore të përlogaritur.

Komponentët e rrezikut të marrjes në sigurim të biznesit të jetës përfshijnë edhe rrezikun biometrik (duke përfshirë vdekshmërinë, jetëgjatësinë, sëmundshmërinë dhe paaftësinë) dhe rrezikun e gabimit. Rreziku i gabimit lidhet me normën më të lartë të paparashikuar ose normën më të ulët të gabimeve të policave, anulimeve, ndryshimet në statusin e pagesës (ndërprerjen e pagesës së primit) dhe të ndërprerjeve

7.1 Objektivat e menaxhimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe prej pasigurisë rreth shumës së dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i rastësishëm dhe i paparashikueshëm. Shoqëria e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit dhe disa kontratave të investimeve ku ajo mbart rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.

Risigurimi blihet nga Shoqëria për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risiguroes të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrëveshjeve për humbjen.

Kapitali rregullator menaxhohet (por jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar. Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e probabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe rezervën, rreziku kryesor që Shoqëria ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lindë sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se llogaritja. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperienca tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

7. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

7.2 Strategjia e marrjes në sigurim

Shoqëria ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brënda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur luhatjet e rezultateve të pritshme.

7.3 Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit

Përgjithësisht, të gjitha produktet e Shoqërisë mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë, ne disa raste mbulimi kufizohet ne mbulim të pjesshem, të humbjeve si pasoje e aksidenteve. Produktet e tjera përveç jetës me kursim kanë karakteristikë të njëjta të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me opsionin e ndryshimit të primit nga ana e Shoqërisë. Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshtë.

Sigurimi i jetës për hua

Kontratat e klasifikuara si "Sigurim i Jetës për hua" janë përgjithësisht polica vjetore të rinovueshme që mbulojnë rrezikun e vdekjes dhe ofrohen për bankat së bashku me kredinë. Shuma e siguruar zvogëlohet paralelisht me ripagimin e kredisë.

Sigurimi i kombinuar

Sigurimi i kombinuar përbëhet nga polica përmes të cilave Shoqëria shkruam prime të jetes me afat dhe sigurimit shendetesor. Kontratat e jetës me afat shlyejnë përfitimet e garantuara në rast vdekjeje të cilat janë të përcaktuara në shumën e sigurimit fikse që nuk varen nga Shoqëria. Kontratat lëshohen për individë dhe grupe individësh.

Jeta me kursim

"Jeta me kursim" përfshin sigurimin e jetës dhe gjithashtu përfshin edhe një komponent kursimi. Përfitimet nga ky produkt i merr i siguruari nëse ai/ajo jeton në datën e maturimit të policës ose trashëgimtarët në rast të kundërt. Data e maturimit varion nga 5 deri 30 vjet. Në rast të daljes nga sigurimi gjatë tre viteve të parë të policës, Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ndaj policëmbajtësit. Pas kësaj periudhe, Shoqëria paguan vlerat e përcaktuara nga kushtet në policë. Produkti është afatgjatë dhe me përfitime të garantuara, madhësia e të cilave pritet të rritet në të ardhmen. Përfitimi në rast vdekjeje është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin dhe shumën e siguruar e cila varion nga 2,400 Euro deri në 50,000 Euro.

Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut

Risigurimi përdoret për të menaxhuar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjësinë e Shoqërisë si siguruari kryesor. Nëse risiguruari nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Shoqëria është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Aftësia paguese e risiguruarit analizohet çdo vit duke rishikuar pozicionin e tyre financiar përpara së të nënshkruajnë kontratën. Shoqëria ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin nga humbjet nga kontratat e nënshkurara dhe të minimizojë efektin e humbjes nga sigurimi i jetës, duke nënshkruar kontrata risigurimi.

7.4 Ekspozimi që lidhet me ngjarjet katastrofike

Shoqëria konsideron se gjatë aktivitetit të saj të sigurimit ajo nuk ka akumuluar ekspozime të rëndësishme ndaj ngjarjeve katastrofike.

7.5 Interesi teknik

Norma e interesit teknik përdoret kur llogaritet rezerva. Norma e interesit teknik është kthimi minimal i garantuar për çdo kontratë të sigurimit të jetës. Për të shmangur rrezikun që të ardhurat nga investimet nuk do të mbulojnë kthimin minimal të garantuar, Shoqëria ka përdorur një normë interesi prej 1.75% në llogaritjen e rezervave matematikore. Në vitin 2018, të ardhurat neto të gjeneruara nga investimet (duke përfshirë rezervat matematikore) mbulojnë të ardhurat minimale të garantuara për një pjesë të portofolit, duke dhënë fitim shtesë mbi interesin teknik. Analiza e parametrave aktuarialë të përdorur në llogaritjen e tarifave dhe rezervave të sigurimit të jetës tregon se supozimet janë të përshtatshme.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***7. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)****7.6 Rezervat dhe supozimet aktuariale**

Shoqëria llogarit dhe ngarkon rezervat e sigurimit për jetën (rezervat matematikore) për të paraqitur pagesat e ardhshme nën policat e sigurimit me afat të gjatë. Shumë faktorë ndikojnë llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva për sigurimin e jetës është llogaritur në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë.

Shoqëria llogarit dhe ngarkon rezerve teknike për të siguruar pagesat e ardhshme sipas politikave afatgjata të sigurimit. Shumë faktorë ndikojnë në llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva teknike llogaritet në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve është i kufizuar në analizën e parametrave kryesorë që kanë ndikimin më të rëndësishëm në llogaritjen e rezervës. "Vdekshmëria" është rreziku që mbulohet nga të gjithë produktet e sigurimit që Shoqëria ka.

Të dhënat lidhur me "vdekshmërinë" për vitin 2018 dhe 2017 duke përfshirë vlerësimet e përdorura janë si më poshtë:

	2018	2017
Numri i personave të siguruar të prekshëm nga rreziku i vdekjes	9,041	7,871
Mosha mesatare e personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	43	43
Numri i pagesave për të siguruarit që kanë vdekur	1	1

Supozimet dhe ndjeshmeria

Faktorët kryesorë që ndikojnë në fitimin e Shoqërisë janë raporti i nivelit të dëmeve dhe shpenzimeve. Tabela më poshtë paraqet një simulim, duke marrë në konsideratë ndryshimet për dëmet e ndodhura ose rritje në shpenzime dhe efektin e tyre në kapitalin neto të Shoqërisë dhe aftësinë paguese në dispozicion. Për qëllime të simulimit, modeli përdor një rritje të dëmeve të barabartë me dëmin më të madh të ndodhura gjatë dy viteve të fundit dhe një rritje të shpenzimeve administrative prej 10%.

31 dhjetor 2018	Fitimi (Humbja)	Kapitali neto	Fondet e garancisë së detyrueshme
Aktual	268,736	4,661,712	3,200,000
Rritje në dëmet e ndodhura	(25,000)	4,636,712	3,200,000
Rritje në shpenzime (+10%)	(44,658)	4,592,054	3,200,000

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kualitative të ndjeshmërisë. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë tregues të tillë si raporti i humbjes së pritur. Shoqëria e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për rezervën e dëmeve të sigurimit të jetës që njihet në pasqyrën e pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur. Një përmbledhje e humbjeve nga dëmet dhe raporti i kombinuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

	2018	2017
Koeficienti i dëmeve	10.89%	21.04%
Koeficienti i shpenzimeve	57.03%	62.00%
Koeficienti i kombinuar	68.12%	83.03%

Rezultatet e analizës së sensitivitetit që tregojnë impaktin në fitim për vitin janë paraqitur më poshtë. Për këtë lloj sensitiviteti tregohet impakti i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara.

	Ndikimi	2018	2017
Koeficienti i dëmeve			
5% rritje në koeficientin e dëmeve	Humbje	(4,247)	(6,306)
5% zvogëlim në koeficientin e dëmeve	Fitim	4,247	6,306
Koeficienti i shpenzimeve			
5% rritje në koeficientin e shpenzimeve	Humbje	(22,329)	(18,586)
5% zvogëlim në koeficientin e shpenzimeve	Fitim	22,329	18,586
Koeficienti i kombinuar			
5% rritje në koeficientin e kombinuar	Humbje	(26,576)	(24,893)
5% zvogëlim në raportin e kombinuar	Fitim	26,576	24,839

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

7. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

7.7 Risigurimi

Shoqëria cedon rrezikun e sigurimit që të kufizojë ekspozimin e humbjeve duke lidhur marrëveshje të ndara për cdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Shoqëria i bën rreziqeve specifike, i cili është subjekt në disa rrethana, i limiteve maksimale bazuar në karakteristikat e mbulimit. Nën termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakort që të rimbursojë shumën e ceduar në rastin e dëmeve të paguara. Megjithatë, Shoqëria mbetet e detyruar ndaj policëmbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse risiguruesi nuk përmbush detyrimet e tij.

Përqendrimi i rezervave teknike dhe të dëmeve sipas llojit është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Lloji i rezervave	2018			2017		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
RBNS	1,050	-	1,050	56,175-	-	56,175
IBNR	1,050	-	1,050	5,618	-	5,618
Rezervat matematikore	387,611	-	387,611	345,319	-	345,319
Gjithsej	389,711	-	389,711	407,112	-	407,112

Përqendrimi i primit të pafituruar sipas llojit të kontratës është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Linja e biznesit	2018			2017		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Sigurimi jeta me afat	144,089	(1,393)	142,696	73,565	(208)	73,357
Sigurimi personal	14,631	(91)	15,540	12,246	(174)	12,072
Sigurimi jeta me kursim	1,200	-	1,200	911	-	911
Gjithsej	159,920	(1,484)	158,436	86,722	(382)	86,340

8. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rreziqet financiare që lidhen me operacionet e Shoqërisë nëpërmjet analizës së rrezikut të brendshëm që përshkruan ekspozimet sipas shkallës dhe madhësisë së rreziqeve. Këto rreziqe përfshijnë rrezikun e tregut (rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Shoqëria nuk përdor instrumente financiare derivative për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre rreziqeve.

(i) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut mund të përshkruhet si rreziku i ndryshimit në vlerën e drejtë të një instrumenti financiar për shkak të ndryshimeve në normat e interesit, çmimet e kapitalit ose normat e këmbimit valutor. Shoqëria nuk investon në aksione dhe ka instrumente financiare pothuajse ekskluzivisht të shprehura në Euro. Rreziku i normës së interesit është kryesisht me investime të mbajtura deri në maturim që mbahen me norma fikse.

(ii) Rreziku i monedhës

Shoqëria kryen transaksione kryesisht në Euro për të përmbushur kërkesat rregullatore dhe të vetë-imponuara të kapitalit. Rreziku i valutës në portofolin e investimeve menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve/detyrimeve. Shoqëria nuk ka ekspozim ndaj aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedha të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

(iii) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të luhetet si rezultat i ndryshimit të normave të interesit në treg si dhe rreziku që maturiteti i interesave në lidhje me aktivet ndryshojnë nga maturiteti i interesave lidhur me detyrimet e përdorura financimin e këtyre aktiveve. Periudha për të cilën norma e interesit të një instrumenti financiar është e fiksuar tregon dhe ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivitetet dhe detyrimet e Shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut. Shoqëria nuk ka ekspozim të rëndësishëm ndaj rrezikut të normës së interesit me përjashtim të investimeve të mbajtura deri në maturim, depozitat e mbajtura me bankat vendore dhe rezervat e saj matematikore, të cilat fitojnë interes me normat fikse tregtare dhe janë planifikuar të maturohen me datat fikse.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***8. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****Rreziku i normës së interesit (vazhdim)**

	31 dhjetor 2018			
	Pa interes	Interes fiks deri në 1 vit	Interes fiks mbi 1 vit	Gjithsej
Mjete monetare dhe ekuivalente	218,803	-	-	218,803
Depozitat me afat	320,000	1,341,993	2,565,000	4,226,993
Investimet në letra me vlerë	-	4,212	350,000	354,212
Aktive të risigurimit	1,484	-	-	1,484
Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve	437,081	-	-	437,081
Aktive financiare	977,368	1,346,205	2,915,000	5,238,573
Detyrimet nga kontrata e sigurimit	389,711	-	-	389,711
Rezerva për primin e pafituar	159,920	-	-	159,920
Detyrime të tjera	49,585	-	-	49,585
Detyrime financiare	599,216	-	-	599,216
Hendeku i ndjeshmërisë së normës së interesit	378,152	1,346,205	2,915,000	4,639,357

	31 dhjetor 2017			
	Pa interes	Interes fiks deri në 1 vit	Interes fiks mbi 1 vit	Gjithsej
Mjete monetare dhe ekuivalente	289,170	-	-	289,170
Depozitat me afat	-	1,592,270	2,465,000	4,057,270
Investimet në letra me vlerë	-	4,246	350,000	354,246
Aktive të risigurimit	382	-	-	382
Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve	205,943	-	-	205,943
Aktive financiare	495,495	1,596,516	2,815,000	4,907,011
Detyrimet nga kontrata e sigurimit	-	61,793	345,319	407,112
Rezerva për primin e pafituar	86,722	-	-	86,722
Detyrime të tjera	39,714	-	-	39,714
Detyrime financiare	126,436	61,793	345,319	533,548
Hendeku i ndjeshmërisë së normës së interesit	369,059	1,534,723	2,469,681	4,373,463

(iv) Rreziku kredisë

Në rrjedhën normale të biznesit, sapo primet të pranohen, investohen për të paguar detyrimet ndaj mbajtësve të policave të ardhshme. Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë për aktivet financiare si: depozitat me afat, investimet në letra me vlerë, llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë në baza të rregullta, duke monitoruar ekspozimin ndaj depozitave me afat dhe llogarive të arkëtueshme nga sigurimet. Rreziku i kredisë së Shoqërisë është kryesisht me paratë e investuara me Bankën Qendrore dhe bankat komerciale që veprojnë në Kosovë. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare dhe ekuivalente	218,803	289,170
Depozitat me afat	4,226,993	4,057,270
Investimet në letra me vlerë	354,212	354,246
Aktive të risigurimit	1,484	382
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve	437,081	205,943
Gjithsej	5,238,573	4,907,011

Cilësia kreditore e aktiveve financiare është shpalosur në shënimet e tyre përkatëse.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***8. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(v) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk mund të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrimet financiare, kur te arrije afati i përmbushjes. Rreziku i likuiditetit është relativisht i natyrshëm në biznesin e Shoqërisë, pasi që disa aktive të blera dhe detyrimet e shitura mund të kenë karakteristika të likuiditetit që janë specifike. Nëse Shoqëria do të kërkonte shuma domethënëse me një njoftim të shkurtër që tejkalonte kërkesat normale të parasë, mund të haste vështirësi për të marrë çmime atraktive. Shoqëria menaxhon rrezikun e likuiditetit duke monitoruar vazhdimisht flukset monetare të parashikuara dhe aktuale dhe duke përputhur profilet e maturitetit të aktiveve financiare dhe detyrimeve.

Aktivitet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, të detajuara sipas parashikimeve (vetëm për detyrimet e sigurimit) dhe maturitetit kontraktual, shpalosen më poshtë:

Rreziku i likuiditetit	Deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Më shumë se 1 vit	Gjithsej
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	218,803	-	-	218,803
Depozitat me afat	2,291,993	1,000,000	935,000	4,226,993
Investimet në letra me vlerë	4,212	-	350,000	354,212
Aktive të risigurimit	1,484	-	-	1,484
Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve	437,081	-	-	437,081
Gjithsej aktivet	2,953,573	1,000,000	1,285,000	5,238,573
Detyrimet nga kontratat e sigurimit	2,100	-	387,611	389,711
Rezerva për primin e pafituar	159,920	-	-	159,920
Detyrime të tjera financiare	49,585	-	-	49,585
Gjithsej detyrimet	211,605	-	387,611	599,216
Pozicioni neto i likuiditetit më 31 dhjetor 2018	2,741,968	1,000,000	897,389	4,639,357

Rreziku i likuiditetit	Deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Më shumë se 1 vit	Gjithsej
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	289,170	-	-	289,170
Depozitat me afat	1,442,270	150,000	2,465,000	4,057,270
Investimet në letra me vlerë	4,246	-	350,000	354,246
Aktive të risigurimit	382	-	-	382
Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve	205,943	-	-	205,943
Gjithsej aktivet	1,942,011	150,000	2,815,000	4,907,011
Detyrimet nga kontratat e sigurimit	61,793	-	345,319	407,112
Rezerva për primin e pafituar	86,722	-	-	86,722
Detyrime të tjera financiare	39,714	-	-	39,714
Gjithsej detyrimet	188,229	-	345,319	533,548
Pozicioni neto i likuiditetit më 31 dhjetor 2017	1,753,782	150,000	2,469,681	4,373,463

(v) Kapitali rregullator

Sipas kërkesave lokale të Bankes Qendrore, të gjitha shoqëritë e sigurimit për sigurimin e jetës duhet të sigurojnë një kapital minimal prej 3,200 mijë euro dhe kapital minimal të paguar nga aksionarët prej 3,200 mijë.

(vi) Marzha e aftësisë paguese

Në përputhje rregullat dhe rregulloret e BQK-se, marzha e aftësisë paguese llogaritet veçmas për sigurimin e jetës dhe sigurimin plotësues. Marzha e aftësisë paguese, për sigurimin e jetës llogaritet si një shumë e rezultatit të parë dhe të dytë, ku rezultatet e para llogariten si një fraksion prej 4% të rezervave matematikore që kanë të bëjnë me biznesin e drejtpërdrejtë dhe rezultatet e dyta llogariten si një fraksion 0.3% i kapitalit në rrezik shumëzuar me raportin e risigurimit për vitin e fundit financiar. Për sigurimet plotësuese, marzha e aftësisë paguese llogaritet duke marrë parashysh rezultatin më të lartë të dy rezultateve, rezultateve të bazës së primeve ose rezultateve të bazës së dëmeve. Më 31 dhjetor 2018 dhe në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, llogaritjet e marzhës së aftësisë paguese, të paraqitura në tabelat shtese të këtyre pasqyrave financiare, tregojnë se Shoqëria ka aftësi paguese (është solvente).

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***10. Mjete monetare dhe të tjera ekuivalentë**

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Raiffeisen Bank	119,735	194,593
NLB Prishtina	9,419	33,260
ProCredit Bank	19,304	25,463
Banka Private e Biznesit	46,864	15,653
Banka Kombetare Tregtare - BKT	4,535	7,913
Türk Ekonomi Bankası - Teb	6,013	7,879
IS Bank	7,662	2,343
Central Bank of Kosovo - CBK	1,908	1,932
Ziraat Bank	3,363	134
Gjithsej mjete monetare dhe të tjera ekuivalentë	218,803	289,170

Shumica e bankave në të cilat Shoqëria ka llogari rrjedhëse, janë degë të bankave të huaja me vlerësim të përshtatshëm të kredisë. Cilësia kreditore e bankave është shpalosur në shënimin 11.

11. Depozitat me afat me bankat

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Depozitat me afat - bankat lokale tregtare	3,858,000	3,728,000
Depozitë në Bankën Qendrore të Kosovës - BQK	320,000	300,000
Interesi i përlogaritur	48,993	29,270
Gjithsej depozitat me afat me bankat	4,226,993	4,057,270

Bankat në të cilat Shoqëria ka depozita janë listuar më poshtë, shumica e të cilave janë filiale vendase të bankave të huaja. Asnjë prej këtyre bankave vendase nuk ka vlerësime të klasifikimit kreditor.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Banka Kombetare Tregtare - BKT	650,000	650,000
NLB Prishtina	1,115,000	1,115,000
Banka Private per Biznes – BPB	533,000	553,000
IS Bank	520,000	370,000
Ziraat Bank	240,000	240,000
TEB Bank	800,000	800,000
Gjithsej	3,858,000	3,728,000

Norma e interesit për depozitat me afat, gjatë vitit 2018 ishte midis 1.00% dhe 3.00% në vit.

Të gjitha këto banka janë pjesë e grupeve ndërkombëtare bankare përveç BpB, e cila është banka lokale me aksionarë individualë vendorë dhe ndërkombëtarë. Vlerësimet e rrezikut të kredisë të grupeve të tyre përkatëse bankare janë paraqitur më poshtë.

Bank	Grupi	Agjencia e vlerësimit	Vlerësimi i kreditorit afatgjatë (grupi)	Vlerësimi
Raiffeisen Bank Kosovo	Raiffeisen bank International AG	Moody's	A3	Stabile
Procredit Bank Kosovo	Procredit Holding	Fitch	BBB	Stabile
TEB Bank Kosovo	BNP Paribas	Moody's	Ba3	Stabile
NLB Prishtina	NLB	Fitch	BB	Stabile
IS Bank	Turkie IS Bankasi	Fitch	BB+	Stabile
BKT	Banka Kombetare Tregtare	JCR Eurasia	AAA	Stabile
BpB	N/a Banke lokale	N/a	N/a, e pa vlerësuar	N/a, e pa vlerësuar

Bankat lokale të pa vlerësuar janë ato që operojnë në tregun lokal, kanë pronarë lokal dhe janë të mirepozicionuara në treg. Të gjitha balancat e mesiperme me bankat, nuk janë as në vonesë as të zhvlerësuar.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***12. Investime në letra me vlerë**

Investimet në letra me vlerë kanë të bëjnë me investimet në obligacione qeveritare të Republikës së Kosovës. Këto obligacione kanë norma interesi që ndryshojnë nga 2.8% në 3.5%.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Më 1 janar	350,000	656,437
Shtesat	-	-
Investimet e maturuara	-	(300,000)
Rritja e primeve	-	(6,437)
Interesi i përllogaritur	4,212	4,246
Gjithsej investime në letra me vlerë	354,212	354,246

Letrat me vlerë përbëhen nga obligacionet e Qeverisë së Kosovës afati i maturimit i të cilave është 26 shkurt 2021. Rreziku i kredisë konsiderohet i ulët dhe investimet e tilla janë në përputhje me rekomandimet e rregullatorit për investimin e fondit të garancionit (kapitalit neto) të shoqërive të sigurimit në investime me rrezik të ulët të rrezikut të kredisë.

13. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve

Llogaritë e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimeve, përbëhen nga:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi jeta me kursim	37,126	53,660
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi jeta me afat	36,771	38,876
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi i jetës me kredi	364,838	115,615
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet bruto	438,734	208,151
Minus: Provizioni për humbjet nga zhvlerësimi	(1,653)	(2,208)
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet neto	437,081	205,943

Lëvizjet në provizionin për humbjet nga zhvlerësimi janë si më poshtë:

	2018	2017
Balanca hapëse	2,208	6,262
Ngarkesa e vitit	456	2,208
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet, të shlyera	(1,011)	(6,262)
Gjithsej	1,653	2,208

Ekspozimet e Llogarive të arkëtueshme të sigurimeve ndaj individëve të siguruar dhe grupet e mbajtësve të policave monitorohen për vonesa. Shoqëria nuk ka një monitorim individual derisa ditëvonesat të identifikohen. Llogaritë e arkëtueshme në bazë të vjetërsisë janë si në vijim:

	31 dhjetor 2018	%	31 dhjetor 2017	%
Më pak se 3 muaj	422,773	96%	196,719	94%
3 deri në 6 muaj	13,238	2%	4,811	2%
6 muaj deri në 1 vit	2,690	1%	5,646	2%
Më shumë se 1 vit	33	1%	975	1%
Gjithsej	438,734	100%	208,151	100%

Shoqëria drejton ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë në baza të rregullta duke monitoruar nga afër llogaritë e arkëtueshme të saj të sigurimit. Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve më 31 dhjetor bazuar në statusin e tyre të vonesave janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
As të vonuara as të zhvlerësuara	407,458	188,033
Të vonuara por jo të zhvlerësuara	15,314	4,457
Të zhvlerësuara	15,962	15,661
Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve bruto	438,734	208,151
Minus: Provizioni për humbjen nga zhvlerësimi	(1,653)	(2,208)
Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve neto	437,081	205,943

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***14. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim**

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim në fund të vitit përfshijnë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Balanca më 1 janar	26,171	31,035
Rritja e shpenzimeve të shtyra të marrjes në sigurim	(5,224)	(4,864)
Balanca më 31 dhjetor	20,947	26,171

15. Pajisje

	Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	Mobilje dhe instalime	Gjithsej
Kosto:			
Më 1 janar 2017	2,751	1,710	4,461
Shtesat gjatë vitit	1,987	766	2,753
Më 31 dhjetor 2017	4,738	2,476	7,214
Shtesat gjatë vitit	145	200	345
Më 31 dhjetor 2018	4,883	2,676	7,559
Zhvlërësi i akumuluar:			
Më 1 janar 2017	(2,002)	(881)	(2,883)
Shpenzimi i vitit	(464)	(415)	(879)
Më 31 dhjetor 2017	(2,466)	(1,296)	(3,762)
Shpenzimi i vitit	(791)	(525)	(1,316)
Më 31 dhjetor 2018	(3,257)	(1,821)	(5,078)
Vlera kontabël			
Më 1 janar 2017	749	829	1,578
Më 31 dhjetor 2017	2,272	1,180	3,452
Më 31 dhjetor 2018	1,626	855	2,481

16. Pasuritë e paprekshme

Kosto:	Softuere
Me 1 janar 2017	-
Shtesat gjatë vitit	-
Më 31 dhjetor 2017	-
Shtesat gjatë vitit	14,750
Më 31 dhjetor 2018	14,750
Amortizimi i akumuluar::	
Më 1 janar 2017	-
Shpenzimi i vitit	-
Më 31 dhjetor 2017	-
Shpenzimi i vitit	(3,688)
Më 31 dhjetor 2018	(3,688)
Vlera kontabël:	
Më 1 janar 2017	-
Më 31 dhjetor 2017	-
Më 31 dhjetor 2018	11,063

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)
17. Rezerva për kontratat e sigurimit

Detyrime per kontratat e sigurimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Rezerva për dëmet e papaguara	1,050	56,175
	1,050	56,175
Rezerva matematikore – Jeta me afat	1,050	5,618
Rezerva matematikore – Jeta me kursim	387,611	345,319
Rezerva për kontratat të sigurimit, bruto	388,661	350,937
Të arketueshme nga risiguruesit	-	-
Rezervat për kontratat e sigurimit, neto	389,711	407,112

Dëmet dhe perfitimet neto të policëmbajtësëve	2018	2017
Dëmet e paguara		
Shuma bruto	102,343	20,787
Ndryshimi në rezervën e demeve të raportuara por të papaguara (a)		
Shuma Bruto	(55,125)	56,175
Ndryshimi në rezervën e demeve të ndodhura por të pa raportuara dhe rezervës matematikore (b)		
Shuma Bruto	37,724	49,162
Dëmet neto dhe përfitimet e ndodhura	84,942	126,124

(a) Analiza e lëvizjeve në rezervën e njoftuar të demeve të raportuara por të papaguara:

Rezerva për detyrimet nga humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjeve	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Më 1 janar		
Rezerva për dëmet e papaguara	56,175	-
Ndryshimet në rezervën nga kontratat e sigurimit	47,218	76,962
Demet e paguara	(102,343)	(20,787)
- Jeta me kursim	-	-
- Jeta me afat	(71,600)	(787)
- Sigurimi personal	(30,743)	(20,000)
Detyrimet neto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjeve më 31 dhjetor	1,050	56,175

(b) Analiza e lëvizjes demeve të ndodhura por jo të raportuara dhe rezervat matematikore:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Gjendja më 1 janar	407,112	301,775
(Demet e paguara)/demet e ndodhura gjatë vitit	(18,451)	49,162
Demet e reja të raportuara në 2018	1,050	56,175
Gjendja më 31 dhjetor	389,711	407,112

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***18. Rezerva për primin e pafituar nga kontratat e sigurimit**

Rezerva e primit të pafituar sipas produktit përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Rezerva e primit të pafituar - jeta me afat	144,089	73,565
Rezerva e primit të pafituar - jetës personale	14,631	12,245
Rezerva e primit të pafituar - jeta me kursim	1,200	912
Gjithsej	159,920	86,722

Lëvizja e rezervës së primit të pafituar është paraqitur më poshtë.

	2018	2017
Balanca më 1 janar	86,722	55,425
Primet e shkruara gjatë vitit (shënimi 19)	856,497	636,650
Minus: Primet e fituara gjatë vitit	(783,299)	(605,353)
Balanca më 31 dhjetor	159,920	86,722

19. Detyrimet të tjera

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Detyrimet financiare</i>		
Komisioni i pagueshëm	2,094	3,350
Të pagueshme tek furnoret	1,792	13,416
Risigurimi i pagueshëm	1,060	3,397
Shpenzimet e përlogaritura	39,614	17,086
Parapagimet nga klientët	6,308	2,059
Detyrimet tjera	317	406
Gjithsej detyrimet financiare	51,185	39,714
<i>Detyrimet jo financiare</i>		
Tatimi i pagueshëm ne te ardhurat e korporatave	11,447	6,751
TVSH e pagueshme	2,092	890
Të pagueshme ndaj BQK	3,091	1,823
Kontributet pensionale të pagueshme	1,244	956
Tatimi mbi të ardhurat personale	961	690
Gjithsej detyrimet jo financiare	18,835	11,110
Gjithsej	70,020	50,824

20. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është 3.5 milion euro (2017: 3.5 milion euro). Kapitali aksionar përbëhet nga 35,000 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 100 euro për aksion të paguar plotësisht më 31 dhjetor 2018. Aksionet e Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 janë 100% të zotëruara nga SIGAL UNIQA Group Austria sh.a (Shqipëri), (2017: 100% në pronësi të SIGAL UNIQA Group Austria sh.a)

Shoqëria nuk ka deklaruar apo paguar asnjë dividend gjatë dhe në fund të vitit 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***21. Prime të shkruara bruto**

Primet e shkruara bruto sipas produktit përbëhen si më poshtë:

	2018	2017
Sigurimi personal	668,744	445,305
Jeta me afat	119,508	115,457
Jeta me kursim	68,245	75,888
Gjithsej prime të shkruara bruto	856,497	636,650
Tatimi ne te ardhurat e korporatave	42,825	31,833
Gjithsej prime te shkruara, neto nga tatimi	813,672	604,817

Analizë e llojeve të primeve

	2018	2017
Primet e rregullta	923,435	673,046
Primet e anuluar	(66,938)	(36,396)
Gjithsej prime të shkruara bruto	856,497	636,650

22. Shpenzimet e marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim për vitin përbëhen si më poshtë:

	2018	2017
Komisionet	251,918	222,532
Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim (shënimi 14)	5,224	4,864
Gjithsej	257,142	227,396

23. Shpenzime administrative

Shpenzimet administrative për vitin përbëhen si më poshtë:

	2018	2017
Shpenzimet e personelit	102,970	69,443
Shpenzimet e qirase operative	31,080	28,740
Tarifat e mbikqyrjes	11,562	8,595
Shpenzimet e TVSH-se	7,633	6,005
Shpenzimet e konsulences	5,661	11,792
Zhvleresimi dhe amortizimi	5,004	880
Sherbime profesionale	4,809	8,349
Shpenzime udhetimi	4,799	2,149
Kontributi per shoqaten e sigurimeve	1,440	1,440
Shpenzime tjera	14,477	6,939
Gjithsej	189,435	144,332

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në Euro, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***24. Transaksionet me palët të lidhura**

Në datën e raportimit, janë realizuar dhe do të paguhen transaksionet dhe balancat e mëposhtme nga Sigal UNIQA Group Austria sh.a (Shqipëri), mëma e Sigal UNIQA Group Austria sh.a (Kosovë) dhe palët e tjera të lidhura:

Transaksionet me palët e lidhura	2018	2017
Kompensimi i drejtimit	54,060	35,851
Të ardhura nga bashkë-sigurimi me Sigal UNIQA Group Austria sh.a (Kosovë)	32,254	19,862
Shpenzimet nga qiraja e zyres me Sigal UNIQA Group Austria sh.a (Kosovë)	16,627	15,472
Shpenzimet nga bashkë-sigurimi me Sigal UNIQA Group Austria sh.a. (Kosovë)	15,000	-
Shpenzimet nga qiraja e automjeteve me Sigal UNIQA Group Austria sh.a (Shqipëri)	11,000	11,000
Shpenzimet për tarifat e konsulencës së drejtimit me UNIQA Insurance Group AG	5,661	11,792
Shpenzimet nga Primet e ceduara ndaj risiguruesve me Sigal Group Austria sh.a (Shqipëri)	1,061	4,766
Balancat me palët e lidhura		
Të arkëtueshmet nga bashkë-sigurimi me Sigal UNIQA Group Austria sh.a (Kosovë)	8,777	14,394
Të pagueshmet ndaj UNIQA Insurance Group AG	61	11,792
Të pagueshmet ndaj Sigal Group Austria sh.a (Shqipëri)	1,061	4,766
Të pagueshmet ndaj UNIQA Group Austria sh.a (Kosovë)	-	1,386

25. Angazhimet dhe Kushtëzimet**i. Çështjet ligjore**

Ne rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria përfshihet në pretendime të ndryshme ligjore. Megjithatë, ka vetëm një proces gjyqësor të pazgjidhur, në të cilin Shoqëria është pale e paditur, për një klient, kërkesa e të cilit është refuzuar dhe për të cilin Shoqëria ka njohur provizionin përkatës më 31 dhjetor 2018.

ii. Zotimet e qirasë operative

Shoqëria ka zotime qiraje për zyrën e saj qendrore dhe mjetet e transportit. Në përgjithësi, Shoqëria mund të anulohet qiranë duke njoftuar 1 muaj më herët. Në vijim, maksimumi i paanullueshem i angazhimeve të pagueshme brenda një viti është si më poshte:

	2018	2017
Brenda një viti	2,590	250
Gjithsej	2,590	250

26. Ngjarjet pas datës së raportimit

Pas datës së raportimit nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme që do të kërkonte rregullime apo shpjegime në pasqyrat financiare.

SKEDULET PLOTĚSUSE

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Skedulet plotësuese

(Shumat janë në Euro, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)

i. Marzhi i aftësisë paguese

Marzhi i aftësisë paguese bazuar në rregullën e BQK-së nr. 31 më 31 dhjetor 2018 përbëhet si më poshtë:

Sigurimi shtesë i marzhit së aftësisë paguese
Aksident personal

Llogaritja mbi bazën e primit (€)		31 dhjetor 2018
Primi i shkruar neto nga të arkëtushmet nga veprimtaria e sigurimeve	1	856,497
Rezerva e primit të pafitur në fillim të vitit	2	86,722
Rezerva e primit të pafitur në fund të vitit	3	159,922
Primi i fituar ([1] + [2] - [3])	4	783,299
Primi i marrë nga risigurimi	5	-
Totali i primit ([4] + [5])	6	783,299
vlera deri në 10 milion x 18/100	7	140,994
vlera mbi 10 milion x 16/100	8	-
Totali i bazës së primit([7] + [8])	8	140,994
Raporti i risigurimit	9	100%
Marzhi i kërkuar mbi bazën e primit ([8]*[9])	10	140,994
Baza e dëmeve (€)		31 Dhjetor 2018
Dëmet e paguara	11	102,343
Rezerva e dëmeve në fillim të vitit	12	61,793
Rezervat e dëmeve në fund të vitit	13	2,100
Totali i dëmeve ([11] - [12] + [13])	14	42,650
Dëmet deri në 7 milion EUR x 26/100	15	11,089
Dëmet mbi 7 million EUR x 23/100	16	-
Totali ([15] + [16])	17	11,089
Raporti i risigurimit	18	100%
Marzhi i kërkuar mbi bazën e dëmeve ([17]*[18])	19	11,089
Marzhi i aftësisë paguese (€)		31 dhjetor 2018
Maksimumi ([10],[19])	20	140,994

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Skedulet plotësuese
(Shumat janë në Euro, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)
i. Marzhi i aftësisë paguese (vazhdim)
Tabela 2
Marzhi i kërkuar i aftësisë paguese për jetën (përfshirë edhe aksidentet personale)
31 dhjetor 2018

			12.2.
			a, b
faktor (12.2.d)		1	4%
	Pa bonus te ndarjes se fitimit	2	-
	Bonusi i ndarjes se fitimit	3	387,611
Rezervat matematikore bruto	totali	4	387,611
	Pa bonus te ndarjes se fitimit	5	-
	Bonusi i ndarjes se fitimit	6	387,611
Rezervat matematikore neto	Totali	7	387,611
raporti (jo më pak se 0.85)		8	100%
Rezultati i parë (12.2.d) (7)* (1)		9	15,504
	jeta me afat deri në 3 vjet	11	91,818,940
	jeta me afat prej 3 deri në 5 vjet	12	132,061
	sigurime të tjera jete	13	844,402
Kapitali në rrezik	totali ([11]*0.1%+[12]*0.15%+[13]*0.3%)	14	94,550
Kapitali në rrezik neto nga risigurimi		15	92,250,752
Raporti (jo më pak se 0.5)		16	99%
Rezultati i dytë (12.2.e)		17	93,996
Shuma e rezultatit të parë dhe të dytë (9) + (17)		18	109,500
			Këtë vit
Marzha e kërkuar e aftësisë paguese - Jetë (12.2) (18)		19	109,500
Marzha e kërkuar e aftësisë paguese - sigurimet shtese (12.3) (Shiko tabelën 1)		20	30,122
Reduktimi i kapitalit të marzhës së kërkuar të aftësisë paguese(12.4)		21	-
Marzha e kërkuar e aftësisë paguese tontine(12.5)		22	-
Marzha e kërkuar e aftësisë paguese lidhur me njësi(12.6)		23	-
Marzhi i kërkuar i aftësisë paguese (19)+(20)		24	
Fondi i garancisë (13.1) ([24] / 3)		25	46,541
Fondi i garancisë (13.2)		26	3,200,000
Fondi i garancisë (max([25] , [26])		27	3,200,000
Marzhi i gatshme i kërkuar i aftësisë paguese (max([24] , [27])		28	3,200,000

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Skedulet plotësuese

(Shumat janë në Euro, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)

i. Marzhi i aftësisë paguese (vazhdim)

Tabela 3

Marzhi ne dispozicion e aftësisë paguese

Seksioni 11.2		31 dhjetor 2018
Kapitali aksionar i paguar (a)	1	3,500,000
rezerva (b)	2	-
Fitimet e pashpërndara (c)	3	1,161,712
Humbjet e mbartura (c)	4	-
rezervat e fitimit (d)	5	-
aksionet (d)	6	-
Totali (1+2+3-4+5-6) Totali (1+2+3-4+5-6)	7	4,661,712
Fondi i garancisë	8	3,200,000
Mjaftueshmëria (Seksioni 13)	9	1,461,712
Marzha të tjera të gatshme të aftësisë paguese (12.3., 12.4.)	10	-
Totali i marzhit të gatshem të aftësisë paguese (7+ 10)	11	4,661,712
Marzhi I kerkuar i aftësisë paguese (Shiko tabelën 2(24))	12	139,622
Mjaftueshmëria e marzhit të aftësisë paguese (11-12)	13	4,522,090

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Skedulet plotësuese

(Shumat janë në Euro, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)

Aktivitet në mbulim të rezervave teknike

Në përputhje me Rregulloren e BQK-së për investimet e aktiveve në mbulim të rezervave teknike dhe matematike, Shoqëritë e sigurimeve që veprojnë në Kosovë mund të investojnë në kategoritë vijuese të mjeteve që mbulojnë rezervat teknike:

Aktivitet në mbulim të rezervave teknike	31 dhjetor 2018	
	% maksimale bruto e rezervave teknike që mund të investohen sipas rregullores	Aktivitet në mbulim të rezervave teknike
a) Depozitat në valutën euro në bankat e licencuara në Kosovë;	-	4,178,000
b) Bono thesari, letra me vlerë dhe instrumente financiare të tregut të kapitalit, të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me maturim	-	350,000
c) Bono thesari, letra me vlerë dhe instrumente financiare të tjera të tregut të kapitalit, të lëshuara dhe të garantuara nga bankat qendrore të qeverive të vendeve anëtare të BE, me një gradë krediti jo më të ulët se BBB	20% në total 5% Individuale	-
d) Pasuritë e paluajtshme (toka, ndërtesat), si dhe aktivitet e tjera fikse të vlerësuara sipas normave të amortizimit;	30% in total 10% Individuale	-
e) Paratë e gatshme, paratë në bankë dhe depozitat me afat maturimi jo më pak se 3 muaj në bankat e licencuara nga BQK-ja në Republikën e Kosovës;	3%	16,489
f) Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimet që rrjedhin nga aktivitetet e sigurimit, të cilat nuk janë më të vjetra se 90 ditë nga data kur detyrimi ka ndodhur.	Palimit për => BBB 25% for < BBB	-
g) Pjesa e risigurimit të rezervave teknike;	Palimit për => BBB 25% për < BBB	1,484
h) Interesi i përlllogaritur që rrjedh nga investimet në depozita bankare dhe letra me vlerë të tjera;	5%	27,482
i) Llogaritë e arkëtueshme deri në 90 ditë, që lindin nga sigurimi, agjentët dhe agjentët, por jo më shumë se njëzet përqind (20%) të rezervës së papaguar bruto të primit;	20% të Rezervës se primit të pafitur	31,984
j) Astet e tjera fikse	5%	2,481
Totali i aktiveve në mbulim të rezervave teknike dhe matematike		4,607,920
Rezervat teknike dhe matematike		549,631
Mbulueshmëria në përqindje		838%